

Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershor 2021

Ndryshimi i SNRF16

Ndryshimi i SNRF 16 *Qiratë*

Është ndryshuar paragrafi 46B. Janë shtuar paragrafët C1C dhe C20BA - C20BC. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Qiramarrësi

...

Matja

...

Matja e mëpasshme

...

Ndryshimet e qirasë

...

46B Lehtësimi praktik në paragrafin 46A zbatohet vetëm për koncesionet e qirasë që ndodhin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë covid-19 dhe vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (a) ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton në një shumë të rishikuar të qirasë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shuma për qiranë menjëherë para ndryshimit;
- (b) çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat që fillimisht ishin për t'u paguar deri më 30 qershor ~~2022~~ (për shembull, një koncesion qiraje do të plotësonte këtë kusht nëse rezulton në pagesa të reduktuara të qirasë deri më 30 qershor ~~2022~~ dhe rritje të pagesave të qirasë që shtrihen përtej 30 qershorit ~~2022~~); dhe
- (c) nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

...

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

...

C1C Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021, të publikuara në mars 2021, ndryshuan paragrafin 46B dhe shtuan paragrafët C20BA – C20BC. Një qiramarrës do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 prill 2021 e më pas. Zbatimi i mëparshëm është i lejuar, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare të paautorizuara për t'u publikuar në 31 Mars 2021.

Periudha kalimtare

...

Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19 për qiramarrësin

...

C20BA Një qiramarrës do të zbatojë Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021 (shih paragrafin C1C) në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit për herë të parë të këtij ndryshimi, si një rregullim të tepriçës në çelje të fitimeve të pashpërndara (ose të një përbërësi tjetër të kapitalit, nëse është më e përshtatshme) në fillim të periudhës raportuese vjetore në të cilën qiramarrësi zbaton për herë të parë këtë ndryshim.

C20BB Në periudhën raportuese në të cilën një qiramarrës zbaton për herë të parë Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021, një qiramarrës nuk është i detyruar të japë informacione shpjeguese që kërkohen nga paragrafi 28 (f) i SNK 8.

C20BC Duke zbatuar paragrafin 2 të këtij Standardi, një qiramarrës do të zbatojë me koherencë lehtësinë praktike në paragrafin 46A vazhdimisht për kontratat që plotësojnë kushtet me karakteristika të ngjashme dhe në rrethana të ngjashme, pavarësisht nëse kontrata i plotësoi kushtet për lehtësimin praktik si rezultat i zbatimit nga qiramarrësi i Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 (shih paragrafin C1A) ose i Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021 (shih paragrafin C1C).

